



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E SHTIMES

MUNICIPALITY OF SHTIME/ OPSTINA STIMLJE

Zyra e Kryetarit të Komunës

Kancelarija presednika opstine/mayor's office

Zyra për Informim/ Information Office/ Kancelarija za Informisanje



Nr.prot. 02/1110/1

Datë 23.09.2025

Procesverbal nga dëgjimi buxhetor me grupe të nënpërfaqësuar (gra, të rinj, pensionistë, persona me aftësi të kufizuara etj), e mbajtur më 8 shtator (e hënë) 2025, në ora 16:00, në Sallën e Kuvendit të Ndërtesës së Komunës

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryetari i Komunës së Shtimes Qemajl Aliu, Besnik Ahmeti (DFB), Lirim Halimi (Kryqi i Kuq - Shtime), Flamur Muhadini (Shoqëria Civile), Ilaz Kadriaj (Q.K.M.F), Mervete Hasani (Q.K.M.F), Agim Mustafa (Q.K.M.F), Maliq Neziraj (Biblioteka e Qytetit), Albion Shabani (Komuna Shtime), Bardhyl Rushiti (K.K Shtime), Adnan Ademi (K.K. Shtime), Zejnije Velu (K.SH), Hysen Hoxha (ambientalist) dhe Vlora Hyseni (Zyra për Komunimim me Publikun)

Qemajl Aliu: Sot jemi këtu bashkërisht me ftesën tonë për të gjithë qytetarët, për dëgjimin buxhetor, për kategoritë, profesionistët personat me aftësi të kufizuar, pensionistët për periudhën 2025-2026.

Besnik Ahmeti (Drejtor në drejtorinë për Buxhet dhe Financa): Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Kemi ardhur sot në këtë fazë të buxhetit, buxheti fillon me u përgatit prej datës 15 maj dhe më 30 shtator dorëzohet në Ministri të Financave dhe ne siç e tha edhe kryetari i kemi mbajtur dëgjimet buxhetore në të gjitha fshatrat, përfshirë edhe dëgjimin buxhetor në qytetin e Shtimes. Këtë muaj, pra në shtator janë të parapara edhe dëgjimet me personat me nevoja të veçanta dhe me pensionistët, partitë politike, klubet sportive, OJQ-të të cilat mbahen në ditët në vijim. Buxheti, i cili këtë vit, pra për vitin 2026 është 11.443.985 euro, krahasuar me vitin e kaluar pra kemi rritje të buxhetit prej 666 mijë eurosh i cili është i ndarë në pesë kategori ekonomike:

1. Pagat
2. Mallra dhe shërbime

3. Subvencione
4. Shpenzime komunale
5. Investime kapitale

Te pagat ndahen 6.8 milionë, që është një rritje në krahasim me vitin e kaluar për rreth 800 mijë, mallra dhe shërbime është 1.5 milionë, mallra 230 mijë, subvencione është 500 mijë dhe investime kapitale 1.480.918 euro që në total është 11.443.985, pra buxheti për vitin 2026. Në këtë dëgjim publik i shohim shumicën e kërkesave që kanë rrjedhë si rezultat I diskutimeve publike me të gjithë banorët e komunës së Shtimes. Edhe në këtë dëgjim publik i mirëpresim të gjitha pyetjet në mënyrë që buxheti të punohet në mënyrën më të mirë të mundshme për vitin 2026. Ky buxhet është për këto kategori ekonomike, pra është final, është për shkak se ka ardhur qarkorja e dytë, dhe pra janë përfundimtare për vitin 2026. Kjo është pra një paraqitje më shumë në vija të trasha, unë e kisha hapur diskutimin që më shumë të diskutojmë.

Hysen Hoxha: Përhëndetje kryetar dhe të gjithë të pranishëm, në emër të pensionistëve, kam përcjellur buxhetin edhe në shtëpi kam vërejtur që disa mjete janë më shumë të rumbullaksume, dhe nuk besoj që do të dalin për me u përfundu.

Ju falënderoj për punët e mëdha që keni bërë deri tani në të gjitha fshatrat jo vetëm në qendrën tonë, por kam një kërkesë, të mirëbajtjes të ambientit. Rrugët janë bërë shumë të mira, por do të dukeshin edhe më mirë sikur qytetarët të kujdeseshin për to, por të ketë edhe kompani të pastrimit.

Janë bërë aq shumë punë, sa nuk di as çka na mungon, vetëm ti ruajmë këto, faleminderit.

Lirim Halimi: Përhëndetje për të gjithë nga Kryqi i Kuq, kam dy shqetësime pse është që te bursat u është ndaluar të marrin, kurse IT edhe për të rritur të përgatitet edhe të rinjtë me tregun e punës, edhe trajnimeve për persona me aftësi të kufizuara, të mbulohen shpenzimet e udhëtimit deri në dërgimin në Ferizaj e deri në dërgimin në QAP dhe të gjitha që iu kushtojnë këtyre personave. Faleminderit.

Qemajl Aliu: Unë ju falënderoj secilin prej jush, ju keni përgjegjë ftesës tonë e keni ardhë në këtë dëgjim që është shumë i rëndësishëm dhe na ndihmon edhe ne për me orientu sa ma drejt e sa ma korrekt buxhetin komunal edhe me qenë në shërbim për të gjitha kategoritë. Sa i përket ambientit, Haxhi unë të falenderoj për kontributin që e keni dhënë vazhdimisht, ne e dimë që Komuna e Shtimes për këto 4 vite ka punu shumë më projekte emergjente që kanë qenë mungesa në arsim, mungesa në shëndetësi, në infrastrukturë, në rrugë, shtrati i lumit, gjërat që kanë qenë në mungesë edhe e vërteta është që ambienti pak qalojnë. Do të mirremi në mandatin e ardhshëm shumë më shumë. Kemi themeluar edhe ekosistemin të cilët jemi në fazën e fundit të funksionalizimit shumë shpejt do të hapim një thirrje edhe për rikujtimin e punëtorëve dhe besoj që në pranverën tjetër punëtorët që vijnë në Komunën e Shtimes do të jenë më korrekt. Sa u takon bursave - kemi gjetur një rregullore skandaloze, kemi bërë disa ndryshime. Ndërsa te qendra e inovacionit keni të drejtë, do të mendojmë edhe për të rriturit. Ndërsa për

subvencionimin e transportit të personave me aftësi të kufizuara në QAP të Ferizajit, do të shohim së bashku me Drejtorinë e Shëndetësisë.

Besnik Ahmeti: A keni kërkesa të tjera apo pyetje tjera?! Projektet që ka vërejtur Haxhia, janë projektet 2 apo 3 vjeçare. Edhe për personat me aftësi të kufizuara kemi paraparë 4 punonjës profesionalë, që do të dalin në ndihmë personave me nevoja të veçanta.

Maliq Neziraj: A do të rritet numri i personave me aftësi të kufizuara, ka që mund të kryejë një shërbim, i lehtësohet barra e familjes, disa nga ne mund ta punsojmë.

Besnik Ahmeti: Komuna e Shtimes me arsim, me shëndetësi, me njësitë e saj që qoftë zjarrfikësit, qoftë kultura, për vitin e ardhshëm ka 40 vende të lira të punës, prej tyre 4 janë për personat me aftësi të kufizuara, plus një rast me sa e di është në procedurat e rekrutimit, që besoj që brenda këtij muji do të ketë procedura të rekrutimit. Këto 4 vende a 6 janë përzgjedhur për çerdhe të Petrovës, 4 janë për njësi primare në të cilat kemi me kry shërbime për personat me aftësi të kufizuara, jo vetëm për ata po për të gjithë shoqërinë, për të gjithë ata që kanë nevojë për ato shërbime edhe 4 vende janë për t'gjitha institucionet tjera të Komunës së Shtimes.

Maliq Neziraj: Ne pasi mundemi me e kry një shërbim, me rëndësi është me e pasë një punë edhe i hiqet një barrë familjes, 3 fëmijë, 2 prindër, vetë me aftësi të kufizuar çka pret n'muaj, 3 fëmijët n'shkollë, rahatohesh dikun qohesh në mëngjes e din ku ki me shku, e din çka t'pret krejt mundemi ta bëjmë nga një shërbim, unë prej 2013 nuk kam punu, para 4 viteve kam punu 2 herë përmes zyrës së punësimit dhe më jo. Çka me prit prej prindit, veç që s'ka mbetë në karrocë, prej këmbës. Ka shumë që janë tu ndejtë, por disa munden me e gjetë veten ku të duan. Ka vende të ndryshme me e sistemu ndonjë, po në këtë rast e falënderoj kryetarin dhe të gjithë.

Lirim Halimi: A ka mundësi të paktën të punësohet edhe ndonjë person me aftësi të kufizuar që mund të kryejë shërbime të tjera?

Adnan Ademi: Faleminderit, por te ndërmarrja ashtu siç ka thënë edhe kryetari që dy vite e gjysmë drejtoria e shërbimeve publike ka punuar punë të jashtëzakonshme, prezent këtu është edhe drejtori, te ndërmarrja te punët fizike nuk mund të punojnë, por nëse një person me aftësi të kufizuara parashihet që mund të punojë në pjesën e menaxhmentit, pasi që edhe me ligj edhe me rregulla të konkursit dihet që mund të punojë aty.

Hysen Hoxha: Përshëndetje, disa fjalë rreth kësaj kompanie. Kjo kompani do të na ndihmonte shumë dhe është një kompani shumë e qëlluar nën menaxhimin e komunës. Në këtë kompani duhet të jeni tepër të kujdesshëm, këtu kanë me u bë punë shumë, ka me pasë angazhim fizik shumë, çdo problematikë që e prishë ambientin këta punëtorë kanë me e nxjerrë problemin, nuk do të doja të punësohen punëtorë vetëm që të rehatohen, por punëtorë që vërtetë punojnë dhe që e duan vendin, e që e bëjnë punën sikur në oborrin e vet. Të mos të vazhdohet kontrata më shumë se tre muaj derisa të sigurohemi që është punëtor i mirë. Pastërtia jep një mesazh shumë të mirë, dhe papastërtia një mesazh shumë të rëndë. Faleminderit shumë.

Besnik Ahmeti: A ka dikush pyetje të tjera? Atëherë ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrjen. Faleminderit për kontributin tuaj që ky buxhet të bëhet në mënyrën më të mirë të mundshme.

Takimi përfundoi në ora 17:25

Procesmbajtës:






Mora Hyseni





**Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin buxhetor me grupe të nënpërfaqësuar
(gra, të rinj, pensionistët, personat me aftësi të kufizuara etj)**

Shtime, 8 shtator 2025

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Nënshkrimi
1	Lirim Halimi	Kryqi i Kuv i Kosovës Dega Shtime	
2	HJSEN Hoxha	ARKBIENTIKIST	
3	FLAMUR MUHADINI	SHKIME	F. M
4	ILAZ KADRIJAS	AKMF	
5	Meruete Hasani	A.K.M.F	MHasani
6	AGIM MUSTAFA	AKMF	
7	Melig Nekovaj	Biblioteka Qytetëre	
8	Albion Shaban	Komune Shtime	ASR
9	Bashkim Rushiti	K.K. SHTIME	
10	Adnan Adem	K.K. SHTIME	
11	BESNIK AHMETI	K.K. SHTIME	
12	Zeynife Velin	Shtime	ZVelin
13	Vlora Jypeni	K.K. Shtime	
14			
15			
16			
17			